



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

Tiranë më datë 15.07.2021

**Në vijim të raportimeve disinformuese në media, informojmë si më poshtë:**

AZHBR ka si detyrë dhe përgjegjësi që të mirëmenaxhojë fondet në përputhje me ligjet në fuqi dhe të maksimizojë efektin e tyre në ekonomi në përputhje me objektivat e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në varësi të masës së mbështjetjes ku aplikanti po aplikon, bën verifikimin e statusit ligjor dhe financiar të tij përmes 12-15 dokumentave të ndryshëm të lëshuar nga Institucione të ndryshme Publike, për të konfirmuar përputhshmërinë ligjore dhe financiare të Programit. Këto dokumenta janë të listuara në formularin e Aplikimit, që bëhet publik për çdo thirrje dhe për çdo masë mbështetjeje, së bashku me vetëdeklarimet e aplikantit. Për të gjitha rastet kur nuk është plotësuar dokumentacioni i mësipërm, nuk është vijuar më tej shqyrtimi dhe është refuzuar aplikimi.

AZHBR gjithashtu bën verifikimin nëse ka konflikt interesi sipas ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin E Konfliktit Të Interesave Në Ushtrimin E Funksioneve Publike”. Deri më sot nuk kemi patur raste të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural mbetet e hapur për çdo informacion zyrtar që ju nevojitet!

Për më shumë informacion ndiqni: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al)